



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 169 Prot

Tiranë, më 02.12.2009

VENDIM Nr. 14 dt. 23.11.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, “Për Trashëgiminë Kulturore”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 23.11.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

VENDOSI:

I. Lidhur me: Rregulloren e Qendrës Historike dhe Ansamblit Urbanistik Arkitektonik Tradicional të qytetit të Korçës:

1. Ngarkohet IMK të shqyrtojë reflektimin e ndryshimeve të propozuara në rregullore.
2. Propozimet e IMK, Rregullorja dhe Harta Zonifikimit të dërgohen pranë Drejtorisë së Trashëgimisë Kombëtare, për tu shqyrtuar në instancat përkatëse.

II. Lidhur me: Projektet të cilat presin financim:

1. **Të miratojë:** Idenë e rehabilitimit të mbulesës ekzistuese në mozaikun e Tiranës.
Nuk miratohet: “Projekt ideja e rikonceptimit tërësor të mozaikut të Tiranës”.
2. **Miratohet në parim:** “Projekti i restaurimit dhe rehabilitimit të kishës në Derven, Laç”. Të rishikohet projekti në Dhjetor të vitit 2010”
3. **Miratohet:** “Projekti i restaurimit të Teqes së Sheh Dyrri, Tiranë”.
4. **Miratohet:** Preventivi i punimeve për Teqenë e Frashërit, Gjirokastrë, relacion, preventiv. (Vazhdim)
5. **Miratohet preventivi i fazës së parë të punimeve (emergjencës) në:** Projekti i konsolidimit të pikturës murale në kishën Shën Mëria, Dhërmi. Preventivi i plotë i punimeve do të diskutohet në KKR, së bashku me projektin arkitektonik të Manastirit
6. **Miratohet:** Restaurimi i banesës së At Gjergj Fishtës, Lezhë.

7. **Miratohet:** Restaurimi në qytetin “Nikaias”, Klos, Mallakastër.
8. **Miratohet:** Projekt konservimi i ikonës “Ngjallja e Llazarit”, Berat. Të caktohet një specialist nga IMK, për të asistuar në zbatimin e projektit).
9. **Miratohet:** Projekt konservimi i ikonës “Shën Ermalau me një martirë”, Berat. Të caktohet një specialist nga IMK, për të asistuar në zbatimin e projektit).
10. **Miratohet:** Projekt konservimi i ornamentikës së gurtë “Porta e Pashait”, lagja Mangalem, Berat. Të caktohet një specialist nga IMK, për të asistuar në zbatimin e projektit).
11. **Miratohet:** Projekt restaurimi bazilika e Ballshit.
12. **Miratohet:** Projekt përshtatje dhe konsolidimi të banesës me pronar Koçi Përroi G 031, Lagja Goricë, Berat.
13. **Miratohet:** Projekt konservimi, Fortifikimi i lagjes Goricë.
14. **Miratohet:** Projekti i biletarisë pranë parkut Arkeologjik Finiq, Sarandë. Projekti të realizohet me plinta të parafabrikuara.

III. Lidhur me: Diskutimin e projekteve (subjektet private):

Miratohen:

1. Rikonstruksion banese e Edri Kreka, Korçë.
2. Projekt për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale, të kishës së Shën E Premtes, Valsh, Elbasan. (Të hartohet projekti arkitektonik i objektit).

Pikat e tjera të rendit të ditës do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme:

1. Kërkesë për rikonstruksion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
2. Kërkesë për ndërtim banese pranë lagjes kala, Elbasan. Fidelino Halo.
3. Projekt përshtatje fasade për banesën me pronar Zenel Sheshalliu, Zona tampon, Berat.
4. Projekt rikonstruksioni për banesën e Vangjel Felahut, lagja 10 Korriku, Berat.
5. Projekt restaurimi i kompleksit të familjes Nikolin Ujka, Shkodër.
6. Projekt rikonstruksioni + shtesë kati+ shtesë volume ne zonen Tampon, lagjia “10 Korriku”, Berat. Ambjente banimi dhe sherbimi (dyqan) me bodrum, Pronaret: A. Xhimitiku , K. Trendafili.
7. Projekt për ndërtimin e një Bar-Bufe, zona Tampon (Qafë e Kalasë), objekt i qytetarit Haxhistasa, Berat.
8. Projekt përshtatje dhe rikonstruksion i banesës së Sotir Koli Bualit, lagjia 13 shtatori, zona Tampon, Berat
9. Projekt restaurimi Manastiri i “Shën Prodhomit”, Voskopojë
10. Rikonstruksion banese dhe shtesë kati i banesës së Aleko Përgjika, lagjia nr.12, rruga “Veteranët”, nr.26, Korçë.
11. Projekt rikonstruksioni dhe përshtatje e kompleksit të banesave të djegura, lagjia Goricë, Berat.

12. Zëvendësimi i çatisë së drurit, me soletë beton arme, për banesën e pronarit Arben Biçoku, Berat.
13. Projekt përshtatje, e pamjeve zona tampon hotel i "DASARET", me pronar Ilir Sulanji, Berat.
14. Studimi fotogrametrik i Kalasë së Beratit (paraqitur nga PACARD).
15. Projekt restaurimi banesa Kristo Kamberi, Gjirokastër.
16. Projekti i ngritjes të një kati në banesën ekzistuese me pronar Dhimitër Kaleshi në lagjen "Kala", Elbasan,.
17. Projekt restaurimi përmirësimi i pamjes së jashtme të ish dyqanit të luleve M 050, lagja Mangalem, Berat.
18. Projekti i hapje porte dhe dritare në objektin Art Studio (ish aneksi i shkollës 7 Nëndori), me pronar Z. Agron Polovina M 110, lagja Mangalem, Berat.

IV. Lidhur me: Diskutim projekti kërkuar nga institucionet shtetërore, jonë varësi të MTKRS:

1. Kërkesë për leje rikonstruksioni ish ambientet e Institutit të Arkeologjisë dhe palestrën sportive në zgjatim të saj.
Miratohet me vërejtjen: Të përsëriten dritaret e vogla në tre kate (imitacion i dritareve të vogla të projektit original). Kornizat e dritareve të jenë me suva, për të bërë të mundur dallimin mes fazave në të cilat është ndërhyrë në objekt.

V. Lidhur me: Diskutimi i projekteve të infrastrukturës:

1. **Nuk u diskutua:** Projekti i rehabilitimit të hidrovorit të Fushës së Vrinës, Sarandë.
2. **Miratohet:** Kërkesë për miratim kompleksi turistik, rezidencial, hotelier në Gjirin e Lalzit. Gjatë zbatimit projekti të survejohet nga IMK dhe ASHA.
3. **Miratohet:** Rikonstruksion i rrugëve këmbësore turistike në hyrje dhe dalje tek Ura e Mesit. Shkodër. Gjatë zbatimit projekti të survejohet nga DRKK Shkodër, IMK dhe ASHA. Autori i projektit theksoi se nuk ka ndërhyrje në monument.

VI. Lidhur me: Diskutim i kërkesave për licensë:

Miratohet:

1. Kërkesë e znj. Adelina Baballëku, për pajisje me licensë të Kat. A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, për nënkategoritë (A/2, A/3, A/4).
2. Kërkesa e Sokrat Kuvarati, për pajisje me licensë të Kat. B. Restaurim i veprave të artit dhe objekteve muzeale, për nënkategoritë (B/2,B/3).

3. Kërkesa e Mantho Bozhorit, për pajisje me liçensë të Kat. B. Restaurim i veprave të artit dhe objekteve muzeale, për nënkategoritë (B/2,B/3).
4. Kërkesa e Ing. Romen Çeçi, për pajisje me liçensë të Kat. A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, për nënkategoritë (A/2, A/3, A/4).
5. Kërkesa e Ing. Genc Samimi, për pajisje me liçensë të Kat. A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, për nënkategoritë (A/2, A/3, A/4).

Nuk miratohet:

1. Kërkesa e Hasan Nallbani për pajisje me liçensë të kat B.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
FERDINAND XHAFERRI

SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA